



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:183682
Datë: 02.09.2024
Numri i dokumentit: 06113035

K.DH.SH.II.nr.1492/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Franciska Zhitija Ymeri kryetare e kolegjit, Dren Rogova dhe Krenar Berisha, anëtarë të kolegjit, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit “T.B.” Sh.p.k, me seli në Magjistralen Prishtinë Mitrovicë, kundër të paditurës-kundërpropozuesi, Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim i vendimit, me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, K.F.nr.369/24 të datës 05.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 02.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditësit-propozuesi “T.B.” Sh.p.k, me seli në Magjistralen Prishtinë Mitrovicë, ndërsa VËRTETOHET Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, K.F.nr.369/24 të datës 05.07.2024.

A r s y e t i m i

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, është vendosur si në vijim;

I. “REFUZOHET propozimi-kërkesa e paditësit “T.B.” Sh.p.k, me seli në Magjistralen Prishtinë Mitrovicë, sipas të cilës ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ përfundimtar-vendimit me nr.prot.219/24 të datës 14.06.2024, të të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë.

II.Procedura sipas padisë në këtë kontest tregtar administrativ do të vazhdoj sipas rregullave të procedurës në konfliktin administrativ dhe sipas planit të punës së Gjykatës.”

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë e paditësi përmes të autorizuarit të tij, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës administrstive, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit “T.B.” Sh.p.k, si e bazuar, të anulohet aktvendimi KF.nr.369/2024 datës 05.07.2024 dhe të shtyhet ekzekutimi i vendimit nr. 219/2024 datë 14.06.2024 deri sa gjykata të vendos me vendim të formës së prerë lidhur me padinë.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi-propozuesi “T.B.” Sh.p.k, me seli në Magjistralen Prishtinë Mitrovicë, pranë Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, ka iniciuar konflikt administrativ kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, ndaj vendimit nr.219/24 të datës 14.06.2024. Paditësi së bashku me padi, ka propozuar - kërkuar edhe shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ përfundimtar - vendimit

me nr.219/24 të datës 14.06.2024, të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë.

Dhoma e Shkallës së Parë ka marrë aktvendimin e ankimuar me arsyetim se, nga propozimi - kërkesa për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të të paditurës dhe shkresave tjera të lëndës, Gjykata nuk ka gjetur prova relevante me të cilën do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit të organit administrativ në këtë rast. Ka cek se propozuesi në kërkesën për shtyrje të ekzekutimit nuk ka dëshmuar se është përmbushur kushti i rrezikut serioz dhe dëmi i riparueshëm, se ekziston rreziku i shkakimit të dëmit apo humbjeve të tjera, nëse nuk caktohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit kontestues. Rrjedhimisht përveç të theksuarit në padi edhe kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të kontestuar, Gjykata e shkallës së parë vlerëson se paditës/propozuesi, në kontekst të të argumentuarit nuk ka ofruar asnjë provë apo dëshmi të cilat do ta mbështesnin pretendimin e paditësit se ekziston mundësia e shkakimit të dëmeve apo humbjeve të tilla, përkatësisht për cilat arsye shtyrja e ekzekutimit është e domosdoshme. Propozuesi në kërkesën për shtyrje të ekzekutimit ka bashkangjitur si provë: vendimin kontestues, draft raportin e kontrollit, raportet e kontrollit, ankesën ndaj raportit të kontrollit, kartelën financiare të subjekti Korabi Sh.p.k, kartelën e klientit dhe furnitorit të subjektit Hani Sh.p.k, llogaritë e pagueshme të këtu propozuesit, dhe listën e pagave e të cilat dokumente në asnjë rrethanë nuk dëshmojnë se është përmbushur kushti i rrezikut serioz dhe dëmi i riparueshëm, se ekziston rreziku i shkakimit të dëmit apo humbjeve të tjera, nëse nuk caktohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit kontestues, por se këto dokumente janë prova që trajtohen dhe vlerësohen me rastin e shqyrtimit të padisë dhe vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues. Gjykata duke vlerësuar propozimin - kërkesën e paditësit dhe shkresat e lëndës e të cilat në tërësi u referohen vetëm pretendimeve të padisë ka konstatuar se paditësi -propozuesi i masës nuk e ka bërë të besueshme me asnjë provë konkrete se ekzekutimi i vendimit kontestues do të mund ti shkakonte ndonjë dëm të riparueshëm, e i cili do të mund të riparohej me vështirësi, ashtu siç është përcaktuar me nenin 22, paragrafi 6, e lidhur me paragrafin 2, të këtij neni, të LKA-së. Krejt në fund ka cek se propozimi - kërkesa e paditësit për shtyrje të ekzekutimit të aktit administrativ përfundimtar - vendimit të të paditurës nr.prot.219/24 të datës 14.06.2024, është e pa bazuar.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit, në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit 03.L-202 për Konfliktet Administrativ.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Në rastin konkret paditësi, me propozimin e ushtruar, kërkon që të caktohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit nr.prot.219/24 të datës 14.06.2024, e lëshuar nga e paditura, deri në vendosjen meritore të kërkesëpadisë lidhur me këtë lëndë.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të paditësit, në ankesë ndaj aktvendimit të Dhomës së Shkallës së Parë, Kolegji vlerëson se të njëjtat janë jo të qëndrueshme, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa dhe për tu lejuar shtyrja e ekzekutimit të vendimit të ankimuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe vlerësimi i Kolegjit është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së. Sepse, kërkesa tërësisht është e mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe pretendimet me të cilat gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë për Departamenti Fiskal, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së propozuesit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurit, me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar. Meqë në këtë rast paditësi, nuk ka bërë të besueshme pretendimet se janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, e me të cilin do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit duke ju referuar dispozitave ligjore, të nenit 22 par.2 të LKA-së. Prandaj, pretendimet ankimore janë të paqëndrueshme sepse nga provat

të cilat gjinden në shkresa të lëndës siç janë; vendimin kontestues, draft raportin e kontrollit, raportet e kontrollit, Ankesën ndaj raportit të kontrollit, po ashtu ka bashkangjitur edhe kartelën financiare por që është e një subjekti tjetër Korabi ShPK, kartelën e klientit dhe furnitorit të subjektit Hani Sh.p.k, llogaritë e pagueshme të këtu propozuesit, dhe listën e pagave por të cilat dokumente nuk janë të përcjella edhe me dëshmi bankare për të vërtetuar gjendjen faktike, dokumentet e bashkangjitura nga paditësi-propozuesi në asnjë rrethanë nuk dëshmojnë se është përmbushur kushti i rrezikut serioz dhe dëmi i pariparueshëm, se ekziston rreziku i shkakimit të dëmit apo humbjeve të tjera, nëse nuk caktohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit kontestues, andaj edhe kolegji i kësaj gjykate gjenë se paditësi-propozuesi me prova të cilat ja ka bashkangjitur kërkesës në fjalë nuk janë bindëse dhe nuk e mbështetin pretendimet e paditësit-propozuesit se ekziston mundësia e shkakimit të dëmit apo humbje të tilla, andaj, kolegji i kësaj gjykate erdh në përfundim se propozuesi-paditësi kërkesën për shtyrje të ekzekutimit nuk e ka bërë të besushëm me prova bindëse dhe konkrete, që me ekzekutimin e vendimit kontestues do të mund të shkaktohet ndonjë dëm të pariparueshëm, e cila do të mund të riparohej me vështërsi, ashtu siç parashihet me nenin 22 paragrafi 6 e lidhur me paragrafin 2 të LKA-së.

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoj pretendimet ankimore lidhur me at se në kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit i është bashkangjitur gjendja e llogarisë bankare në NLB dhe gjendja e llogarisë bankare në RBKO (provë numër 4 dhe 5 në kërkesë) me të cilat prova dëshmohet se paditësi nuk ka mjete financiare në llogarit bankare, një pretendim të till kolegji i këaj gjykate e refuzoj si të pa bazuar për shkak se në kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit përveç se vetëm është përmendur gjendja e llogarisë bankare të NLB-së dhe asaj të RBKO-së, e që në shkresa të lëndës nuk ishin si prova gjatë procedimit në gjykatën e shkallës së parë, por me ankesë paditësi-propozuesi ja ka bashkangjitur vetëm gjendjen e llogaris bankare të RBKO-së, ndërsa gjendjen e llogaris së NLB-së nuk gjindet fare në shkresa të lëndës e as me ankesë, andaj duke u bazuar në nenit 180 par.1 të LPK-së, me të cilën parashihet se: *“Në ankesë nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të propozohen prova të reja, përveç se kur ankuesi jep prova se pa fajin e vet nuk ka mundur t’i paraqesë, përkatësisht t’i propozojë gjer në përfundimin e shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë”*, e që paditësi-propozuesi nuk i ka parashtruar këto prova në procedurën e zhvilluar në shkallë të parë andaj gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka bazuar në provat që kanë qenë në shkresa të lëndës respektivisht në provat e prezantuar nga paditësi-propozuesi i cili konform nenit 319 të LPK-së, ka për detyrë të provojë faktet mbi të

cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Kështu, paditësi-propozuesi provat kontestuese i ka parashtruar vetëm në gjykatën e shkallës së dytë dhe nuk ka dhënë prova se pa fajin e vet nuk ka mundur t'i paraqesë, përkatësisht t'i propozojë gjer në përfundimin e procedurës në gjykatën e shkallës së parë, kjo gjykatë vlerësoj edhe pretendime tjera ankimore, por gjeti se të njëjtat nuk kanë ndikim ndryshe në vendosje lidhur me këtë rast, andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr. 1492/24 datë 02.09.2024

Kryetarja e Kolegjit
Franciska Zhitija Ymeri